

Në bazë të nenit 28 paragrafi (2), nenit 30 paragrafi (1) dhe nenit 45 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në përbërje: Mr. Borçe Razmoski – Kryetar, Mr. Malinka Siljanovska Nikoliq, Aleksandar Trgaçevski, Nikolla Trajçevski dhe Valon Elezi – anëtarë, duke vepruar sipas detyrës zyrtare kundër NDËRMARRJES PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP, me seli në rr. "Boro Todoroviq" nr. 2, Shkup, Gazi Babë, e përfaqësuar nga Sabahadin Rustemi – person i autorizuar, për vërtetimin e kundërvajtjes së kryer nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në seancën e mbajtur më 11.07.2025 solli këtë:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se NDËRMARRJA PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP, me seli në rr. "Boro Todoroviq" nr. 2, Shkup, Gazi Babë, e përfaqësuar nga Sabahadin Rustemi – person i autorizuar, me NUAS: 4528972, NUT: 4030992102919, llogaria rrjedhëse nr. 300-000000398027 në Bankën Komerciale, nuk ka vepruar sipas Konkluzionit për dorëzimin e të dhënave nr. 08-98 të datës 15.11.2023 të Komisionit në afatin e përcaktuar, dhe në kuptim të nenit 49 të Ligjit, në atë mënyrë që nuk i ka dorëzuar të dhënat e kërkuara me konkluzionin e theksuar në afatin e përcaktuar i cili skadonte më 26.11.2023, si ditë deri kur NDËRMARRJA PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP ishte e obliguar t'i dorëzojë të dhënat e kërkuara dhe me këtë ka kryer kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, për çka i shqiptohet sanksion – gjobë në shumë prej 60.000,00 denarë, që paraqet 0,00439% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të NDËRMARRJES PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP të realizuara në vitin 2024, si viti i fundit afarist për të cilin e njëjta ka përpiluar llogari vjetore.

2. Gjobën nga pika 1) të këtij vendimi, kryerësit e kundërvajtjes janë të detyruar ta paguajnë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit në llogarinë e transaksionit të përfituesit: 100-0000000630-95, llogaria e pagesës: 840xxx07337 - gjoba për kundërvajtje të kryera nga fusha në kompetencë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me shifër të të ardhurave 722139 dhe program 00, pranues i urdhrit – Ministria e Financave, banka e pranuesit – BPRMV dhe deri te Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të dorëzojnë dëshmi/kopje nga pagesa e kryer e gjobës në afat prej 15 ditësh nga pagesa e kryer. Gjoba e papaguar ose gjoba e papaguar në kohë, do të arkëtohet në rrugë të detyrueshme. Padia e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Arsyetim

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës me shkresën nr. 08-21 të datës 15.04.2024 deri te Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dorëzoi kërkesë për inicimin e procedurës kundërvajtëse.

Me kërkesën, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës kërkon që Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të iniciojë procedurë sipas detyrës zyrtare ndër të tjera edhe për NDËRMARRJEN PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP, me seli në rr. "Boro Todoroviq" nr. 2, Shkup, Gazi Babë, me 4528972 dhe numër

unik tatimor: 4030992102919 e përfaqësuar nga Sabahadin Rustemi – person i autorizuar, për shkak të mosveprimit sipas konkluzionit nr. 08-98 të datës 15.11.2023 për dorëzimin e të dhënave në afatin e përcaktuar, dhe në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, që paraqet kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Më tej në kërkesë theksohet se NDËRMARRJA PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP deri te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk i ka dorëzuar të dhënat e nevojshme, në afatin e përcaktuar ligjor prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të konkluzionit nr. 08-98 të datës 15.11.2023, respektivisht nuk ka dorëzuar: Sasitë e përgjithshme të blera të letrës së mbeturinave nga personat fizikë (mbledhës joformalë) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/grumbulluara të letrës së mbeturinave nga subjekte juridike (krijues të mbeturinave) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/grumbulluara të letrës së mbeturinave nga subjekte të tjera (të ceket cilat) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera të plastikës së mbeturinave nga personat fizikë (mbledhës joformalë) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/grumbulluara të plastikës së mbeturinave nga subjekte juridike (krijues të mbeturinave) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/grumbulluara të plastikës së mbeturinave nga subjekte të tjera (të ceket cilat) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera të qelqit të mbeturinave nga personat fizikë (mbledhës joformalë) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/grumbulluara të qelqit të mbeturinave nga subjekte juridike (krijues të mbeturinave) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/grumbulluara të qelqit nga subjekte të tjera (të ceket cilat) nga territori i qytetit të Shkupit.

Qëllimi i sigurimit të të dhënave ka qenë që Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, si organ kompetent për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25) të kryejë vlerësim të drejtë të njoftimit të parashtruar për përqendrim ndërmjet KAPKA STAR RECYCLING SHPK, Umka Serbi dhe NUTRIVET SHPK Shkup, të cilët kanë pasur qëllim të kryejnë bashkimin e biznesit për grumbullimin, transportin, magazinimin dhe trajtimin e mbeturinave të parrezikshme të NUTRIVET SHPK Shkup me biznesin e EKO STAR RECICLAZHA SHPKNJP Shkup.

Duke marrë parasysh faktin se NDËRMARRJA PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP konkluzionin nr. 08-98 të datës 15.11.2023 e ka pranuar më 16.11.2023 dhe nuk ka vepruar sipas konkluzionit, respektivisht nuk i ka dorëzuar të dhënat e kërkuara, në afatin e përcaktuar, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës kërkoi që Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtje si organ që udhëheq procedurën kundërvajtëse para Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe shqipton sanksion kundërvajtës për kundërvajtjet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, sipas detyrës zyrtare të inicojë procedurë kundërvajtëse kundër Higjienës Komunale Shkup, për vërtetimin e kundërvajtjes eventuale nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Duke e pasur parasysh atë që u tha më lart, e për arsye se NDËRMARRJA PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP nuk ka vepruar në afatin ligjor të përcaktuar për përgjigje sipas Konkluzionit 08-98 të datës 15.11.2023, KVK pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në seancën e mbajtur në ditën 21.02.2025, solli Konkluzion për iniciimin e procedurës kundërvajtëse PK nr. 09-39/1 me të cilin Konkluzion, KVK kërkoi që NDËRMARRJA PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP t'i dorëzojë deri te KVK

dokumentet dhe të dhënat në vijim: Ekstrakt nga Regjistri Qendror për gjendjen rrjedhëse; Bilancin e suksesit për vitin 2023 dhe Të dhëna për llogarinë rrjedhëse, numrin unik tatimor dhe deponentin – bankën në afat prej 8 ditësh.

Konkluzioni është dorëzuar me shkresë përcjellëse PK nr. 09-39/2 të datës 21.02.2025.

Në ditën 06.03.2025 NDËRMARRJA PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP dorëzoi përgjigje ndaj Konkluzionit për iniciimin e procedurës kundërvajtëse PK nr. 09-39/1 dhe me të njëjtën i dorëzoi të dhënat dhe dokumentet e kërkuara.

Në ditën 04.04.2025 KVK solli Njoftim paraprak për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-39/4.

Njoftimi paraprak për gjendjen faktike të vërtetuar është dorëzuar te NDËRMARRJA PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP me shkresë përcjellëse PK nr. 09-39/5 të datës 07.04.2025.

Në ditën 30.05.2025 KVK solli Njoftim përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-39/6.

Njoftimi përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar është dorëzuar te NDËRMARRJA PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP me shkresë përcjellëse PK nr. 09-39/7 të datës 30.05.2025.

Në ditën 30.06.2025 NDËRMARRJA PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP dorëzoi deri te KVK përgjigje ndaj Njoftimit përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-39/8 dhe në shtojcë të së njëjtës dorëzoi: kopje të ekstraktit nga Regjistri Qendror, kopje të bilancit të suksesit për vitin 2023, të dhëna për llogarinë rrjedhëse dhe deponentin bankën dhe përgjigje ndaj kërkesës dhe tabelën FK COTC 8.5 – Pasqyrë e sasive të grumbulluara të Pet ambalazhit, letrës, ambalazhit të kartonit, najlonit dhe qelqit për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022.

Pas sigurimit të të dhënave të nevojshme me rëndësi për vendimmarrje të drejtë në procedurën kundërvajtëse dhe nga provat e mbledhura në vendngjarje, si dhe nga deklarimi pas njoftimit paraprak dhe përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar të NDËRMARRJES PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP, KVK vërtetoi se:

NDËRMARRJA PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP nuk ka vepruar sipas Konkluzionit për dorëzimin e të dhënave nr. 08-98 të datës 15.11.2023 të Komisionit në afatin e përcaktuar, dhe në kuptim të nenit 49 të Ligjit, në atë mënyrë që nuk i ka dorëzuar të dhënat e kërkuara me konkluzionin e theksuar në afatin e përcaktuar i cili skadonte më 26.11.2023, si ditë deri kur NDËRMARRJA PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP ishte e obliguar t'i dorëzojë të dhënat e kërkuara dhe me këtë ka kryer kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Në pajtim me nenin 61 paragrafi (1) të LMK, KVK ndërmarrjes, respektivisht shoqatës së ndërmarrjeve, me vendim do t'i shqiptojë gjobë në shumë deri në 1% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të realizuara në vitin e fundit afarist, e shprehur në vlerë absolute dhe nominale për të cilën ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve ka përpiluar llogari vjetore nëse:

-Nuk vepron sipas konkluzionit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës ose Komisionit për vendimmarrje për kundërvajtje për dorëzimin e të dhënave në afatin e përcaktuar, dhe në kuptim të nenit 40, nenit 48 dhe nenit 49 të këtij ligji.

Të ardhurat e përgjithshme të NDËRMARRJES PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP të realizuara në vitin 2024 arrijnë 1.366.665.553,00 denarë.

Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës vërtetoi se shuma e gjobës e cila i shqiptohet NDËRMARRJES PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP për kundërvajtjen e kryer nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës arrin 60.000,00 denarë, që paraqet 0,00439% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të NDËRMARRJES PUBLIKE HIGJIENA KOMUNALE-SHKUP të realizuara në vitin 2024, si viti i fundit afarist për të cilin e njëjta ka përpiluar llogari vjetore.

Për shkak të gjithë asaj që u theksua më lart u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Padia e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KOMISIONI PËR VENDIMMARRJE PËR KUNDËRVAJTJTE
KRYETAR
Mr. Борче Размоски